VENDIM
Nr. 27, datë 20.1.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË DHE KURBIN

(Ndryshuar me VKM nr. 772, datë 12.12.2022; nr. 672, datë 6.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 561 260 803 (një miliard e pesëqind e gjashtëdhjetë e një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e tre) lekë, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Tiranë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 840 575 731 (tetëqind e dyzet milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekë;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi në masën 720 685 072 (shtatëqind e njëzet milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e dy) lekë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, në masën 312 252 160 (treqind e dymbëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, nga bashkitë Tiranë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 168 115 146 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e gjashtë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi në masën 144 137 014 (njëqind e dyzet e katër milionë e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërmbëdhjetë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 592 639 074 (pesëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 387 370 974 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 205 268 100 (dyqind e pesë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind) lekë, pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, në masën 574 119 996 (pesëqind e shtatëdhjetë e katër milionë e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH,

për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 218 675 601 (dyqind e tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 355 444 395 (treqind e pesëdhjetë e pesë milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë dhe Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe